

Me shfaqjen „Vetëvrasës” të autorit Nikollaj Erman, me regji të Sulejman Rushitit, koproduksion i teatrit „A. Zako Çajupi” nga Korça dhe Teatrit kombëtar – Tirana, sonte në Qendrën e Kulturës „ASNOM” në Gostivar, fillon edicioni i dytë i Festivalit ndërkombëtar të teatrit „Othello” ...



Gjatë pesë mbrëmjeve të festivalit, prej 5 deri 9 nëntor, nga ansamblet e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës, do të shfaqen pesë shfaqje teatrore në gjuhën shqipe.

Festivali do të ketë karakter garues, ndërsa juria profesionale do të ndajë çmime për aktorin më të mirë, aktoren më të mirë, regjisorin më të mirë dhe shfaqjen më të mirë.